



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 25.07.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berat Lahu (LVV), Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

**Mungoi:** Rita Zeqiri (LVV).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki, drejtor i Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve dhe Faruk Kukaj e Mehreme Llumnica, përfaqësues nga "Handikos".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Doruntinë Maloku**, drejtoreshë, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e gjashtë "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhevdet (Ahmet) Rafunës dhe Nuhi (Ahmet) Rafunës", për shkak të një mosmarrëveshjeje në mes investitorit dhe pronarëve të pronave.

**Përparim Rama**, kryetar, propozoi që në rend të ditës të futet pika: Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban D2, në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.

**Valbona Makolli**, në emër të një projekti të Drejtorisë së Bujqësisë dhe kërkësës së Ministrisë së Financave, propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika:

"Propozimvendimi për hapjen e kodit buxhetor".

**Plator Gërdovci**, drejtor, tha se për këtë projekt do të jetë participimi prej 20% të fermerëve në projektin për furnizim dhe montim të serrave, i cili është projekt i vitit të kaluar, mirëpo gjatë këtij viti është e pamundur që ato mjete të alokohen për shkak të mungesës së kodit buxhetor.

**Arta Balaj**, drejtoreshë, propozoi që në rend të ditës të futet pika: Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Prishtina International Film Festival".

**Gëzim Sveçla** tha se është për keqardhje që gati çdo seancë, tash e tetë muaj, duhet të fillojmë me ankesat tona, të cilat janë plotësisht të arsyeshme dhe në lidhje me çështje teknike. Tash e sa mbledhje nuk po e kemi në dispozicion procesverbalin nga mbledhjet e kaluara. D.m.th. për njëzet vjet ky Kuvend gjithmonë si pikë të parë të rendit të ditës e ka pasur votimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake.

Po ashtu, vërejtja tjetër e vazhdueshme ka të bëjë me materialet për seancë, ku asnjëherë në këto gjashtë seanca sa i kemi bërë deri sot, nuk e kemi pranuar materialin ashtu siç parashihet me ligj.

Gjithashtu, po propozohen pika shtesë për rendin e ditës, dhe ne nuk e dimë se çka është ajo, nuk kemi asnjë material. Në këtë seancë nuk kemi asnjë raportim për ndërmarrjet publike nga aksionarët e rinj, asnjë ndryshim në qasje dhe në vizion, shumë pyetje për të cilat nuk kemi marr përgjigje! Është premtuar që të silllet në Kuvend Rregullorja për "Prishtina Parking", e cila ende nuk ka ardhur. Për çështjen e planit të lagjes "Arbëria", ne jemi ata të cilët ju kemi lutur që mos ta anuloni këtë plan urbanistik të asaj lagjeje, janë shkaktuar tensione në këtë seancë, kemi kërkuar që të na dëgjoni, kemi pasur argumente të arsyeshme që nuk ka nevojë të anulohet një plan i tillë, kur dihet se edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit pati deklaruar publikisht që asnjë plan i ri nuk do të aprovohet, nuk do të miratohet pa përfundimin e hartave zonale.

Edhe ne si grup parlamentar, propozojmë që në rend të ditës të futet pika: "Diskutim mbi gjendjen në Ndërmarrjen Publike Banësore".

**Gëzim Mehmeti** u shpreh se për mua është shqetësuese, por edhe nënçmuese që të votohet Plani rregullues për lagjen "Arbëria" dhe ne mos të kemi material paraprak.

Po ashtu, është diskriminuuese, sepse në mbledhjen në të cilën janë anuluar planet rregulluese të lagjeve "Arbëria" dhe "Kalabria", në këtë rast ne po i diskriminojmë banorët e lagjes "Kalabria".

Ai propozoi që ky propozimvendim të mos futet në rend të ditës.

**Amir Simnica** propozoi që me rastin e vdekje së regjisores Vjosa Berisha dhe të qytetarit Erdin Haxhiu, që ndërroi jetë nga fatkeqësitë natyrore, të mbahet një minutë heshtje.

**Kryesuesi** ftoi anëtarët e Kuvendit që të mbajnë një minutë heshtje.

**Bahri Gashi** bëri vërejtje kryesisht rreth materialeve, duke thënë se materialet po na sillen pjesë-pjesë dhe me vonesë. Sa i përket Planit rregullues të lagjes "Arbëria", po na krijohen situata të palakmueshme, ta dimë kush ka votuar dhe kush e ka hequr herën e fundit nga rendi i ditës edhe kush po e bie tash përsëri në rend të ditës. Jeni duke e përmirësuar një gabim që e keni bërë në raport me miqtë tanë të dashur dhe po e përmirësoni, të paktën silluni në këtë raport. Po ashtu, keni sjellë një rregullore jashtë çdo norme ligjore, dhe kërkoni votën nga ne!

**Nora Kelmendi** propozoi që nga rendi i ditës të hiqet "Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës".

**Alban Zogaj**, nënkryetar, tha se ne e kemi një arsyetim të fortë pse kërkojmë me e përfshi në diskutim publik këtë rregullore. Pra, sot po propozojmë që kjo rregullore të cilën ne e kemi përgatitur për ju dhe qytetarët e Prishtinës, të dalë në diskutim publik, pastaj ky diskutim publik na jap kohë edhe me punuar tutje, edhe ju me i dhënë komentet e juaja, por edhe qytetarët e Prishtinës.

Trotinetet elektrik sot janë pjesë e jetës sonë, i kemi kudo nëpër rrugët e kryeqytetit të Prishtinës.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk jemi në kundërshtim me rregullores për trotinet, mirëpo është e rëndësishme me e pasur atë rregullore në përputhje me ligjin. Me daljen e kësaj rregulloreje në diskutim publik, është me i vënë qytetarët në lajthitje, me diskutuar për diçka që nuk ka bazë ligjore.

**Ilirik Musliu**, drejtor, tha se është e vërtetë që teknologjia na ka gjetur pa përgatitur edhe neve, jo vetëm neve, por edhe shumë kryeqytete tjera, në këtë rast edhe nivelin nacional, prandaj me mikromobilitet duhet gjithsesi të trajtohet edhe pjesa e iskuters. Gjithnjë e më shumë po vjen duke u rritur numri i tyre, pra ata gjithkund të lirë po shëtitën. Nuk shoh asgjë të keqe që ne po fillojmë me e përgatitur një projektregullore të tillë.

**Berat Lahu**, konsideroi se mënyra se si po procedohet kjo rregullore nuk qëndron, andaj tha se si mund të jetë kjo ide e juaja që këtë rregullore ta përgatitni derisa të vjen ligji, e kur të vjen ligji e përshtatni në bazë të ligjit. Konsideroj se kjo nuk ka fare logjike. Nuk jemi as ndërmarrje private, jemi institucioni më i lartë në Komunën e Prishtinës, nuk mundemi ne me thënë po e miratojmë derisa të bëhet ligji dhe kërkujmë që kjo projektregullore të hiqet nga rendi i ditës.

**Gëzim Mehmeti** tha se pa marrë parasysh, një rregullore e tillë është më se e nevojshme, por duke pasur parasysh se si po procedohet, kërkojmë që kjo projektregullore të riformulohet, të plotësohet dhe më pas të na silltet në Kuvend. Nëse e votojmë si të tillë, konsideroj se ne po bëjmë shkelje ligjore.

**Arben Kçira**, zyrtar nga Zyra ligjore, tha se të gjithë e dimë se me ligj nuk është i rregulluar specifikisht mikromobiliteti, mirëpo në kuadër të kompetencave të përgjithshme që i ka Komuna në transportin lokal, mundeni me u thirr në atë dispozitë.

**Muhamet Selmani** tha se ne po flasim për një rregullore që ndoshta ligji nuk e ka paraparë, por që është shumë e domosdoshme të përcaktohen disa rregulla, prandaj për këtë arsye edhe në çoftë se ligji nuk ekziston nuk duhet ta ndaloj. Ne duhet ta bëjmë një rregullore, me të cilën i kufizojmë ose i parashohim disa rregulla me të cilat duhet të lëvizin këto pajisje.

**Jeta Rafuna - Hasani** theksoi se edhe ne si Grup parlamentar e përkrahim këtë projektregullore, prandaj duke pasur parasysh që kjo rregullore e rregullon edhe zonimin, moshën edhe mbajtjen e helmetës, atëherë pajtohemi gjithsesi që të jetë në rend të ditës.

**Endrit Zabërgja** u shpreh për hartimin e një rregulloreje e cila u garanton një transport të lirë dhe të sigurt trotineteve, por në të njëjtë kohë nuk jam për ta shkelur ligjin. Konsideroj që kritikën tona duhen të jenë racionale, d.m.th. nëse qëllim i përbashkët është e mira e qytetarëve, atëherë konsideroj që duhet t'i gjejmë format të bashkëpunojmë si pozitë, si opozitë, në mënyrë që qytetarëve t'u garantojmë siguri dhe stabilitet në komunikacion.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se është e pakuptimtë që një pikë të paradiskutohet, e kur hynë si pikë e rendit të ditës, prapë të diskutohet, prandaj kërkoj për ta racionalizuar kohën, t'i qesim propozimet, që nuk janë në numër të vogël, t'i diskutojmë, pastaj të shkojmë në diskutim kur të vijmë si pika të rendit të ditës.

**Triera Kasumi - Berisha** tha se nuk ka asnjë bazë ligjore që kjo rregullore të procedohet më tutje, andaj i bëj thirrje ekzekutivit që përderisa merret me rregullore që nuk kanë nevojë hiq me iu iniciuar këtu në mungesë të bazës ligjore, të punojmë pak më shumë edhe t'i ngremë në diskutim rregulloret të cilat do të duhej të sillleshin në këtë Kuvend kohë më parë, siç është Rregullorja e NP "Prishtina Parking".

**Milazim Vitija** tha se për pika të rendit të ditës ka propozim e jo debat. T'i propozojmë pikat e rendit të ditës, votohen, kur të kalon atëherë ne mundemi me diskutuar për pikën. Mendoj se gjithë ky debat për një pikë është jashtë rregullores.

**Kryesuesi** i hodhi në votim pikat e propozuara, si në vijim:

**Kryesuesi** konstatoi se më 41 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban D2 në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendim për plotësim dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të datës 04. 05. 2015, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 47 vota për, "Propozimvendimi për hapjen e kodit buxhetor", futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 46 vota për "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Prishtina International Film Festival", futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 25 kundër, propozimi për "Diskutim mbi gjendjen në Ndërmarrjen Publike Banesore", nuk futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, 27 kundër dhe 1 abstenim, "Propozim vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës", nuk tërhiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 14 kundër, u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishtëm të bllokut urban D2, në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015;
2. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1 prill – 30 qershor 2022 (TM2);
3. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e pa luajtshme në pronësi të: Valbona (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja dhe Ragip (Shefki) Selimi;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të: Jeton ( Ramiz) Hyseni, Faton (Ramiz) Hyseni dhe Driton (Ramiz) Hyseni;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës;
7. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në Komunën e Prishtinës;
8. Propozimvendimi për aneksplanin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës;
9. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
10. Propozimvendimi për hapjen e kodit buxhetor;
11. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Prishtina International Film Festival";

12. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve në kompaninë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", Prishtinë;
13. Informatë lidhur me raportin vjetor të komisionit të aksionarëve në NPL "Termokos" Prishtinë;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të Bllokut urban D2, në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.**

Gëzim Sveçla kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, të dijë se çka ka ndryshuar nga ai të cilin e kemi anuluar këtu, a ka ndryshuar diçka në aspektin profesional, apo në aspektin teknik në këtë plan, nga ai i cili është anuluar para 4-5 muajsh.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Sveçla, sqarime shtesë dha Arbër Sadiki, drejtor.

Gëzim Mehmeti pyeti se me këtë propozimvendim çka po ndryshohet, cilat janë ndryshimet, prandaj lidhur me këtë ne kërkojmë një sqarim të sakët.

Sami Boroci kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, të dijë se a ka ndonjë afat kur pritet me përfunduar dhe kur pritet me ardhur në Kuvend harta zonale.

**Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të Bllokut urban D2, në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3" të miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.**

#### **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës për periudhën 1 prill – 30 qershor 2022 (TM2).**

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1 prill – 30 qershor 2022 (TM2), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Mirsad Vitija ngriti shqetësim rreth këtij raporti financiar, duke thënë se sa i përket të hyrave, ky raport flet vetëm për kategoritë ku ka rritje të të hyrave, por jo edhe aty ku ka rënie, si në tatimi në pronën e paluajtshme, qiraja në banesa, të hyrat nga inspeksioni, mbeturinat, hortikultura, lejet mjedisore, komunale etj.

Kjo qeverisje ngjashëm si e kaluara, vazhdon të jetë efikase tek shpenzimet paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe shpenzimet komunale, por çalon shumë kur vjen puna tek shpenzimet kapitale, subvencionet dhe transferet.

Tek shpenzimet për projektet kapitale, disa drejtori, siç janë Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Parqeve, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Bujqësisë, të cilat kanë pasur shpenzime kapitale me një përqindje shumë të ulëta, që bën të kuptoj se kjo gjendje është shqetësuese.

**Fisnik Osmani** tha se nëse i referohemi këtij raportit financiar, buxheti për të gjitha kategoritë ekonomike për vitin 2022 është planifikuar në vlerë mbi 90 milionë euro, nga këto mjete për tre mujorin e dytë janë shpenzuar mbi 15 milionë euro, afër 16 milion apo 17.61% e buxhetit të planifikuar për vitin 2022. Ajo që vërehet më shumë është se shpenzimet kapitale janë shpenzuar mbi 1 milion e 3900 euro, afërsisht 1.4 milion euro, ose 4.47% e buxhetit të planifikuar për kategorinë e investimeve kapitale. Nëse e lexojmë raportin e njëjtë për gjashtë muaj, del se kemi realizim mbi 34% të performancës së Komunës.

Shifrat që janë të pasqyruara në këtë raport dhe qeverisja e kryetarit që shohin qytetarët e Prishtinës, e vërteta është se nuk shkojnë njëra me tjetrën, pra kemi një dinamikë në realizim, në lëvizje dhe praktikë dhe një shpenzim të buxhetit jo të kënaqshëm, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale.

**Leutrim Retkoceri** tha se ky raport i pasqyron shpenzimet e një buxheti i cili ka kaluar në mandatin e kaluar. Për më keq, është një raport financiar i cili është ndeshur edhe në dy situata jo të kënaqshme, atë të krizës ekonomike dhe inflacioni që po përcjell, dhe tjetra është e një bllokade të paarsyeshme të organit shqyrtues të prokurimit publik. Prandaj marrë për bazë këto argumente, ky raport nuk është raport që nxjerr ndonjë vlerë edhe ndonjë rezultat pozitiv në shpenzimin e tij. Është me shumë urgjencë që të gjitha drejtoritë që përfshihen në këtë raport, të bëjnë edhe plane rezervë dhe urgjente se si deri në fund të vitit, tre mujorët tjerë të bazohen në këto dy argumente, në mënyrë që realizimi i projekteve të jetë më i lartë.

**Gëzim Sveçla** tha se është për keqardhje për ata qytetarë të cilët kanë votuar për ata asamblistë që nuk merren me çështjet konkrete, por dështimet e nivelit lokal duan t'i bartin te niveli qendror. Mendoj se problemet e qytetarëve të Prishtinës, për të cilët edhe jemi zgjedhur dhe jemi këtu, mund të rregullohen duke i trajtuar vetëm ato probleme e jo duke folur për probleme globale.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shitesë dhanë Alban Zogaj, nënkryetar, Krenar Xhaferi, drejtor, dhe Izet Sadiku, drejtor.

**Fiknete Bejta** tha se raporti financiar buxhetor për tremujorin e dytë të vitit 2022, tregon se qeveria komunale megjithatë ka punuar, mirëpo jo kushtimisht gjithçka është varur prej saj. Tek arkëtimi i mjeteve kemi një rritje më shumë se 12%, tek realizimi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime kemi rritje, d.m.th. si kategori buxhetore që varet tërësisht nga Komuna, faktikisht kemi shpenzim ashtu siç është planifikuar.

Tek ngecja, të gjithë pajtohemi se ngecje kemi tek investimet kapitale, mirëpo realisht ne po pajtohemi që nuk është fajtor as niveli komunal, as ai qendror, në mënyrë indirekte varet prej zhvillimeve globale, rritjes së çmimeve dhe normës së inflacionit.

Nuk mund të fajësojmë një kryetar komune për dështimet, por ndodhin për shkak të mos marrjes së masave nga Qeveria. Është e vërtetë se Asociacioni i Komunave e ka trajtuar këtë problematikë nga muaji mars, janë dy shkresa zyrtare ku është kërkuar që kontratat të rishqyrtohen, kanë kërkuar që çmimi i tyre të rritet në mënyrë të përgjithshme me vlerën 30%, që mund të jetë edhe e arsyeshme. Po ashtu edhe shtrenjtimi i derivateve ka ndikuar në shumë kompani që projektet të ngecin apo të mos realizohen me kohë.

**Feim Osmani** tha se e kuptoj që ka vështirësi në zbatimin e kontratave, edhe kjo është pika që na bashkon në fakt edhe në leximin edhe në vlerësimin e këtij raporti financiar, mirëpo një gjë duhet ta kemi parasysh, që raporti financiar duhet të lidhet ndoshta jo në masën më shumë se 50 % me krizën, sepse i referohet periudhës prill e deri në ditët që jemi tani, që konsiston me shumicën e kontratave të reja që do të kishin mundur të realizoheshin në periudhën kur ne i kemi kuptuar çmimet. Operatorët ekonomik e kanë ditur që kanë me u përballur me çmimet që janë sot, sepse në fakt luhatja e çmimeve prej muajit shkurt kur ka filluar kriza deri sot është diku me 10% e jo më shumë. Po ashtu, ka kontrata që janë të nënshkruara shumë më herët dhe e kanë kaluar edhe atë pengesën e OSHP-së, i kanë kaluar të gjitha afatet e përfundimit, mirëpo nuk janë përfunduar dhe me ato është dashtë që të merret më shumë ekzekutivi.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1 prill - 30 qershor 2022 (TM2).**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022.**

Lidhur me Propozimvendimin për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoare.

**Gëzim Sveçla** tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Donjeta Dragusha** tha se edhe ne si Grup parlamentar këtë propozimvendim për ndryshim dhe plotësim do ta përkrahim, pasi që është kërkesë e Ministrisë së Financave dhe nuk dëshirojmë që ta bllokojmë këtë ndryshim të mjeteve, pra dëshirojmë të vazhdojmë, mirëpo nuk e kemi plotësisht të qartë arsyeshmërinë e kësaj kërkesë tash në këtë fazë.

**Leutrim Retkoceri** tha se edhe ne si grup parlamentar këtë propozimvendim për plotësim dhe ndryshim do ta përkrahim dhe mendoj se nga këtu duhet t'u bëhet apel edhe Ministrisë së Financave, se këto vonesa janë të patolerueshme dhe të jenë rastet e fundit që këto vonesa të bëhen, pasi që me këto raste veç po dëmtohet kryeqyteti ynë, Prishtina.



Endrit Zabërgja tha se edhe ne këtë propozimvendim për plotësim dhe ndryshim e përkrahim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022.

**Pika e katërt**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të: Valbona (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja dhe Ragip (Shefki) Selimi.

**Pika e pestë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të: Jeton ( Ramiz) Hyseni, Faton (Ramiz) Hyseni dhe Driton (Ramiz) Hyseni.

**Pika e gjashtë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës.

Lidhur me tri propozimvendimet për këmbimin e pronave komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi tha se për pikën e katërt dhe për pikën e pestë i keni sjellë certifikatat dhe kopjet e planit, ndërsa për pikën e gjashtë, që kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, nuk kemi marrë certifikatë dhe kopje të planit, përveç që ekzistojnë certifikatat dhe kopjet e planit në dokumentacionin e investitorit kur ka aplikuar për kushtet ndërtimore, prandaj është dashtë të na sillet i tërë dokumentacioni i nevojshëm, ashtu siç e parasheh Rregullorja në fuqi për këmbimin e pronave të paluajtshme.

Jeta Rafuna tha se ne si Grup parlamentar i përkrahim këto këmbime dhe sa herë që është në pyetje interesi publik, ne do t'i shtyjme proceset përpara.

Muhamet Selmani theksoi se edhe ne si Grup parlamentar i përkrahim këto propozimvendime për këmbimin e pronave dhe kërkoj nga drejtorja e Drejtorisë së Pronës, të dijë se para se të na sillen për votim këto vendime për këmbimin e pronave, a mund ta kemi edhe vlerësimin e pronave nga Ministria e Financave, për të përcaktuar vlerësimin e pronave para se të këmben.

Lidhur me çështjen e ngritura nga znj. Kelmendi dhe z. Selmani, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 41 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Valbone (Shaip) Mërkojës, Naser (Shaip) Mërkojës, Fatmir (Shaip) Mërkojës dhe Ragip (Shefki) Selimit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikro-mobilitetit në komunën e Prishtinës.**

Gëzim Sveçla shprehu pakënaqësi për këtë propozimvendim lidhur me projektregulloren për trotinete dhe biçikleta elektrike, duke thënë se si është e mundur që të sillni këtu në Kuvend një dokument të tillë, i cili nuk ka mbështetje ligjore, nuk ka bazë juridike, rrjedhimisht është i paligjshëm. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të rregullt dhe në përputhshmëri me normat ligjore të aplikueshme në vendin tonë, prandaj ju ftoj që ta tërhiqni sot këtë projektregullore nga rendi i ditës, të presim bazën ligjore nga niveli qendror, pastaj të bëjmë një rregullore praktike e konkrete, gjithsesi të ligjshme, që kishte me e rregullua këtë çështje.

Dhurata Jahaj-Retkoceri tha se qëllimi i kësaj rregulloreje është definimi i mjeteve me asistencë elektrike të mikro-mobilitetit për përdorim personal dhe të operatorëve ekonomikë, kushtet dhe kriteret e aplikueshme për mjete, kufizimet e shfrytëzimit për nevoja personale dhe të operatorëve ekonomikë, kushtet e sigurisë në trafik, zonat e ndryshme për ngasje dhe operim të mjeteve, parkimi i mjeteve, zonat e ndaluara, licencimi i operatorëve, shfrytëzimi i të dhënave të gjeneruara, mbikëqyrja e kushteve të operimit të sigurisë në territorin e komunës së Prishtinës. Përmes kësaj rregulloreje në hapësirën publike në territorin e komunës së Prishtinës, po e vëmë në dispozicion të shfrytëzimit të operimit të mjeteve me asistencë elektrike të mikro-mobilitetit sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara.

Leutrim Retkoceri tha se materiali i dërguar është një projekt, i cili meriton të ketë edhe një trajtim dhe një dëgjim publik, dhe të ketë konsulta me qytetarë. Është e saktë ajo se ligj nuk ka për këtë çështje, mirëpo çka duhet të bëhet është t'i përgjigjet një kërkesë dhe një ritmi të madh të përdoruesve të këtyre mjeteve tashmë në kryeqytetin tonë, Prishtinë, dhe kjo duhet të jetë arsye e mjaftueshme që Komuna e Prishtinës të tentojë të paktën të bëjë një zgjidhje.

**Agim Kuleta** tha se pa dyshim që të gjithë pajtohemi me këtë çështje, por dua ta vë në pah emergjencën e kësaj çështjeje, mendoj se është shumë më emergjente sesa ndoshta jemi duke e ndjerë dhe përjetuar. Padyshim se aspekti ligjor është shumë i rëndësishëm, mirëpo në fund të fundit ne e kemi të drejtën për ta interpretuar si çdokush tjetër edhe aspektin ligjor, por nuk jemi autoriteti përfundimtar për këtë interpretim, e kemi edhe një autoritet tjetër sipër, pra dhe jemi që kjo projektregullore të përcillet në diskutim publik.

**Endrit Zabërgja** shprehu bindjen se trajtimi i kësaj projektregulloreje është më se i domosdoshëm, duke pasur parasysh që në substancë meriton kjo rregullore të ketë ndryshime të cilat besoj se do të bëhen pas konsultave publike. Kërkoj që të jetë një koordinim i përbashkët i të gjithave grupeve parlamentare, e në veçanti kërkoj nga GP i LVV-së për një koordinim korrekt, në mënyrë që të bëjmë një zgjidhje të përbashkët jo vetëm për Prishtinën, por për gjithë nivelin nacional.

**Triera Kasumi - Berisha** tha se do të ishte mirë që të kemi dëgjime publike para se të hartohet kjo projektregullore, të cilat adresohen në nivelin qendror, në komisionin i cili i jep ligjshmëri të plotë kësaj çështjeje, pastaj ne merremi me tema të tjera të cilat edhe na takojnë edhe nga ana ligjore.

**Fiknete Bejta** tha se jam pro kësaj rregulloreje, sepse mendoj që e lehtëson problemin në komunikacion. Është e nevojshme për ruajtjen e mjedisit dhe është e përballeshme si kosto, mirëpo të jemi të kujdesshëm kujt po i japim të drejtë pjesëmarrje në komunikacion, sepse duke u dhënë të drejtë në disa elemente që janë pozitive, do ta rrezikojmë jetën e qytetarëve, prandaj dhe ne duhet të dimë saktësisht çka po ndërmarrim, çka po sanksionojmë dhe çka po lehtësojmë me këtë rregullore.

**Pëllumb Bajçinovci** u shpreh i pajtimit me shumicën e debutuesve, se duhet të jetë një projekt apo duhet këto rregulla të jenë të vendosura në formën e ligjit, ku në nivelin qendror nuk ekziston. Ndihet nevoja e shpejtë dhe urgjente për krijimin e disa rregullave dhe të lehtësimit të lëvizjeve të këtyre pajisjeve në rrugë. Me këto pajisje në rrugë janë fëmijët dhe adoleshentët, pastaj edhe gjenerata e re dhe nevoja e rregullimit, nevoja e vendosjes së rregullës është më se urgjente.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikro-mobilitetit në komunën e Prishtinës.

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për aneks-Planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës.**

Lidhur me Propozimvendimin për aneks-Planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Adelina Sahiti, drejtore.

Faqe 1 nga 24

**Mehreme LLumnica**, përfaqësuese nga organizata "Handikos", tha se pas miratimit të Planit aktual të veprimit 2021-2023, që është hartuar bashkërisht me përfaqësuesit e 6 organizatave joqeveritare që merren me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, ne kemi ardhur në një përfundim dhe kemi dalë me një projektdokument, që është paraqitur edhe për nevojat imediate dhe ato me prioritet që nuk janë përfshirë në këtë plan aktual të miratuar gjatë këtij viti. Përmes këtij aneksi edhe zbatimi do të jetë i rëndësishëm, më i lehtë, më i sigurt zbatimi i tij.

**Gëzim Sveçla** tha se edhe ne e përkrahim këtë aneks-plan dhe kërkojmë që i njëjti të fillojë të zbatohet sa më parë që është e mundur, duke filluar pikërisht nga ne këtu, nga Komuna e Prishtinës.

**Ajet Brajshori** theksoi se personat me aftësi të kufizuar janë kategoria më e ndjeshme, që në Prishtinë është diku 10% e popullatës që janë me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë ne si Grup parlamentar e kemi diskutuar edhe çështjen e tyre dhe pa diskutim, që e përkrahim plotësisht duke u mbështetur edhe në projektin bazë të veprimit në vitin 2018-2021, dhe tani me aneks shtesë ne e mbështesim plotësisht. Ky plan është një dokument, i cili paraqet detyrat konkrete dhe të cilat janë të pranueshme nëpër drejtoritë komunale për përmirësimin e gjendjes në të gjitha fushat në punësim, në arsim, pastaj edhe në pjesëmarrjen në aktivitete sportive, kulturore etj.

**Leutrim Retkoceri** tha se ne i Grup parlamentar do t'i mbështesim kërkesat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, dhe është mirë që Planit të veprimit 2018-2023 iu ka bashkëngjitur edhe aneks-Plani i veprimit, e që është shumë e rëndësishme që të gjitha aktivitetet dhe kërkesat që parashihen në këtë plan të jenë të realizueshme më masën më të lartë të mundshme.

**Valbona Ajeti** tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim të aneks- planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, i cili plan apo të cilat kërkesa janë të shtrira në të gjitha drejtoritë.

**Fiknete Bejta** tha se ky plan i veprimit është shumë i domosdoshëm, andaj dhe uroj që mos të jetë vetëm plan i veprimit në letër, por të zbatohet, sepse është një plan i aktiviteteve për këtë komunitet, që në masë të madhe mund t'i zgjidhë shumë probleme që ata i kanë tash për tash.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 41 vota për, u miratua Vendimi për aneks-Planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.**

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiki, drejtor.

Gëzim Sveçla u shpreh në përkrahje të miratimit të këtij propozimvendimi.

**Milazim Vitija** tha se kemi të bëjmë me një propozimvendimin për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal mes Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Obiliqit, për projektin "Solar 4 Kosova", që është një projekt për panelet solare për ngrohjen e kryeqytetit me energji termike.

**Leutrim Retkoceri** tha se e përkrahim këtë pikë dhe urojmë që në të ardhmen të ketë edhe nisma të tjera si kjo.

**Kryesuesi** konstatoi se më 37 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

**Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për hapjen e kodit buxhetor.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Plator Gerdovci, drejtor.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për hapjen e kodit buxhetor.

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Prishtina Internacional Film Festival".**

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Prishtina Internacional Film Festival".

**Pika e dymbëdhjetë**

**Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve në kompaninë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë.**

**Muhamet Selmani**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve në KRM "Pastrimi", tha se pas analizimit të dokumenteve dhe raporteve, sidomos pas daljes së raportit të ZKA-së për vitin 2021, ka vlerësuar se ndryshimet në menaxhment janë të domosdoshme, me qëllim të krijimit të kushteve të reja për operimin e ndërmarrjes. Sipas të dhënave që vijnë nga ekipet punuese, shihet se në ndërmarrje është krijuar një gjendje shumë e rëndë. Ndërmarrja ka një obligim për rreth 1.361 milion euro, ku pjesa më e madhe janë borxh ndaj kompanisë për menaxhimin e deponive të mbeturinave, mbi 630 mijë euro, dhe pjesën tjetër ndaj furnizuesve dhe operatorëve të tjerë. Ndërmarrja ka një staf të mbingarkuar, dhe ka një mosharmoni mes stafit të administratës dhe mungesës së fuqisë punëtore në terren dhe operativë. Një tjetër mangësi e madhe është se ndërmarrja nuk ka një raport përmbledhës vjetor të punës, as raport për aksionarët së paku në 4 vitet e fundit, dhe kjo e komplikon edhe më shumë raportimin tonë të drejtë ndaj gjendjes së kësaj ndërmarrje.

Faqe 13 nga 24

Kërkoj nga kjo asamble që bashkërisht të hartojmë një rezolutë dhe bashkërisht të votojmë, me të cilën e autorizojmë kryetarin e Komunës dhe Komisionin komunal të aksionarëve, të fillojnë procedurat për rregullimin e mënyrës së menaxhimit të kësaj ndërmarrjes, duke mos e përjashtuar edhe ndarjen e ndërmarrjes nga komunat tjera dhe krijimin e një ndërmarrje pastrimi të veçantë vetëm për kryeqytetin. Si aksionar i kësaj ndërmarrje, kërkoj që të mbështetni të gjithë dhe ta autorizojmë kryetarin e Komunës për të gjetur formën më të mirë që të intervenojmë sa më shpejtë për ta subvencionuar këtë ndërmarrje dhe shpëtuar nga falimentimi momental.

**Shegë Beqiri – Badivuku**, në cilësinë e anëtares së Komisionit të aksionarëve në KRM “Pastrimi” tha se menaxhmenti i ri duke e parë gjendjen e rënduar në këtë kompani, ka marrë disa vendime dhe masa emergjente krahas legjislacionit në fuqi, e që janë vetëm fillimi i veprimeve konkrete për përmirësimin e gjendjes së rëndë në këtë kompani, rrjedhimisht përkushtimi për të vendosur rend, rregull, transparencë dhe menaxhim të mirë.

**Arbër Vokri** ngriti shqetësim rreth gjendjes së krijuar në KRM “Pastrimi”, duke thënë se sipas të gjeturave të ZKA-së, është shqetësuese që menaxhimi i kompanisë jo vetëm se ka qenë skandaloz, por duket se edhe ka qenë kriminal, ku mbi 1 milion euro të munguara pa dëshmi për punësime të pa paligjshme, si dhe dukuri të tjera që kompania ka kaluar nga një bilanc pozitiv financiarë në një bilanc negativ. Krijohet përshtypja se degradimi i hovshëm i kompanisë në vitin e fundit të mandatit të qeverisjes së kaluar komunale, ka qenë i planifikuar. Funkcionimi i kësaj kompanie varet prej shumë aspekteve e që përgjegjësinë besoj se e kanë komunat.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se sa i përket informatave që i morën nga të dy aksionarët e kësaj kompanie, mendoj se është shumë e rëndësishme që t’i jepet një drejtim kësaj gjendjeje.

Ai falënderoi kryetarin Rama, i cili ka qenë këmbëngulës në ndryshimin e kësaj gjendje dhe në vizionin që kompania “Pastrimi” t’i shërbejë pikë së pari Komunës së Prishtinës, qoftë në mënyrën e ndarjes, apo në mënyrën e krijimit të një ndërmarrje të re, sepse në këtë gjendje që po flasim ne, mundë të bëjmë përpjekje vetëm ta mbajmë në këmbë këtë ndërmarrje, por nuk besoj se mundemi me shpëtuar nga falimentimi.

**Endrit Zabërgja** tha se çështja e kompanisë “Pastrimi” duhet të jetë prioritet i të gjithëve, në veçanti prioritet i ekzekutivit aktual, duke pasur parasysh se një problem i tillë nuk zgjidhet vetëm prej dy-tre personave, por duhet një vullnet i madh, andaj besoj që do ta keni përkrahjen tonë. Do dëshiroja të dijë se në çfarë kohe ne mundemi me pa ose me konsideruar Prishtinën të pastër ashtu qysh kemi dëshirë tash e sa kohë.

**Fiknete Bejta** tha se kompania “Pastrimi” është në një gjendje shumë të keqe dhe nëse është një ndërmarrje kaq e rëndësishme për qytetin, e që ka ardhur deri në buzë falimentimit, atëherë dikush e ka përgjegjësinë dhe ne duhet të punojmë, të angazhohemi publikisht edhe në këtë seancë, që ata që kanë përgjegjësi faktikisht edhe të dalin para drejtësisë, sepse po shkatërrohet një ndërmarrje komunale, një pronë publike dhe faktikisht po mbetet pa asnjë përgjegjësi.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim, duke thënë se ne duam t'i shpërfaqim disa parregullsi, të cilat natyrisht që duhet shpërfaqur në një ndërmarrje siç është "Pastrimi", mirëpo në anën tjetër nuk po duam të diskutojmë për parregullsitë e shumta edhe më të mëdha që janë në një ndërmarrje tjetër, siç është NPB-ja, e që ne kërkuam që të diskutohet edhe për këtë ndërmarrje. Kjo përveç që nuk është parimore, është dyfytërsi, prandaj është krejt e palogjikshme me kërkuar përkrahje prej opozitës.

Feim Osmani tha se nëse i referohemi pjesës së rekomandimeve, konsideroj se këto kanë ndikim në planin afatgjatë dhe nuk kanë ndikim emergjent, andaj dhe situata është tepër emergjente. Ka vendbanime të tëra në Prishtinë, ku ka më se tri javë që nuk është bërë bartja e mbeturinave dhe këto masa nuk i prekin në asnjë formë dhe absolut shpejt këtë çështje. Mbështetja e këtyre rekomandimeve do të ishte e logjikshme sikur brenda tyre të ishte edhe një masë, e cila e përcakton një hap konkret dhe veprimin të ngutshëm dhe urgjent.

Berat Lahu tha se ne jemi duke u ankuar për pikat e rëndit të ditës që janë sjellë pa dokumentacion, për ato pika ku duhet dokumenti si kusht ligjor. Pra, kur sillen plane me i miratuar duhet me e ditur çka po miratojmë, kur merret një vendim janë disa dokumente që e përcjellin. Ne nuk kërkuam asnjë dokumentacion përkatës rreth diskutimit për NPB, mirëpo ky kuvend ka një vit që diskuton për këtë ndërmarrje, prandaj për rekomandimet të cilat u propozuan për gjendjen në ndërmarrjen "Pastrimi", konsideroj se ato nuk qëndrojnë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Alban Zogaj, nënkryetar, dhe Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

*GP i LVV-së, në shenjë pakënaqësie rreth rrjedhjes së diskutimeve për gjendjen në KRM "Pastrimi", e lëshuan mbledhjen.*

Leutrim Retkoceri tha se duke u bazuar në raportin e fundit të KRM "Pastrimi" i prezantuar nga anëtarët e Komisionit komunal të aksionarëve, si dhe diskutimet e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendit të Kryeqytetit i propozojmë t'i nxjerrë këto rekomandime:

- Udhëheqja e kryeqytetit të ndërmarrë masa të domosdoshme për përmasimin afatshkurtër dhe ndryshimet afatgjate në gjendjen e ndërmarrjes rajonale të mbeturinave "Pastrimi";
- Të bëhet vlerësimi i asetëve të kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", nga vlerësues të licencuar;
- Të bëhet vlerësimi 77% të aksioneve të Komunës së Prishtinës në kompaninë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", nga vlerësues të licencuar;
- Kryetari i kryeqytetit të formojë një task-forcë gjithëpërfshirëse, më qellim të analizës dhe vlerësimeve të mësipërme dhe përgatitjen e rekomandimeve me masa urgjente afatmesme dhe afatgjata;

- Ekzekutivi i Komunës së Prishtinës të hartojë një raport gjithëpërfshirës lidhur me mundësinë e tërheqjes së aksioneve të Komunës së Prishtinës nga kompania rajonale e mbeturinave "Pastrimi", dhe themelimin e një ndërmarrjeje lokale të pavarur, e cila mund t' u ofrojë shërbime në këtë fushë vetëm për komunën e Prishtinës;
- Kryesuesi i Kuvendit të procedojë në Komitetin për Politik dhe Financa, të gjetura nga task-forca, pas aprovimit të këtyre nga kryetari i Komunës;
- Komisioni i aksionareve të fillojë plotësim-ndryshimin e akteve nënligjore të brendshme të kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", duke përfshirë statutin, rregulloret e brendshme dhe të tjera;
- Drejtoria e Financave të gjejë formën për ndihmë financiare për ndërmarrjen, gjetjen e ndonjë granti apo huave, për arsye të gjendjes së rëndë financiare që është në kompaninë rajonale të mbeturinave "Pastrimi".

*Për shkak të mungesës së kuorumit, kryesuesi konstatoi se mbledhja nuk mund të vazhdojë.*

*Vazhdimi i mbledhjes së gjashtë të Kuvendit, më 28.07.2022, duke filluar në orën 10:00.*

**Në mbledhje morën pjesë:** Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berat Lahu (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Rita Zariqi (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Dasmor Durmishi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK) dhe Kushtrim Mushica (AAK).

Në mbledhje morën pjesë edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave.



## **Pika e trembëdhjetë**

### **Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve NPL "Termokos" Prishtinë.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Alban Zogaj, nënkryetar.

**Triera Kasumi – Berisha** tha se raporti i ZKA-së për pasqyrat financiare 2021 të ndërmarrjes publike "Termokos", është tejet shqetësues, duke filluar nga opinionimi i auditit, i cili rezultoi të jetë i kundërt, dhe se ky opinion është i dyti nga opinionet më negative apo të këqija që lëshon auditori i jashtëm. Në tërësi janë mbi tridhjetë gjetje të konstatuara, ku në veçanti janë konstatuar gjetje tek pasqyrat financiare.

Përveç çështjeve të lartcekura, ajo kërkoi të dijë se a do të përfshihen të gjithë qytetarët në shtrimin e rrjetit, sa do të jenë të shpejta procedurat në planifikimin e aplikimeve, meqë po e shihet se punimet po shkojnë shumë ngadalë dhe kur do të bëhet lidhja e banorëve të rrugës "Muharrem Fejza" me rrjetin e ngrohtores.

**Valbona Ajeti** shtroi pyetjen rreth shtrirjes së rrjetit për ngrohje, duke thënë se çka do të ndodhë me ndërtesat, të cilat punëkryesit nuk i kanë lënë hapësirat për stacionet e Termokosit, si do të bëhet shtrirja nëpër hyrjet e banesave kur ka ardhur shtrirja e Termokosit, por vende për stacionet nuk ka në hyrje.

**Endrit Zabërgja** kërkoi të dijë se në çfarë kohe pretendohet të bëhet lidhja e lagjeve të cilat u përmenden, siç është Lagjja e Muhaxhirëve, "Tophane" dhe rruga "Muharem Fejza".

**Fiknete Bejta** tha se ne pajtohemi që përgjegjësitë se çfarë ka ndodhur në Termokos, ato nuk i takojnë kësaj qeverie, mirëpo ata që i lexojnë raportet e auditimit duhet ta kenë të qartë se kur fillon një proces i auditimit, nënshkruhet një deklaratë e pajtueshmërisë dhe deklaratën e pajtueshmërisë e nënshkruan drejtori ekzekutiv, me këtë edhe e merr përgjegjësinë në zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditorit çfarëdo qofshin ato. Në momentin që kryeshefi ka dhënë dorëheqje, ato përgjegjësi vetëm janë arkivuar, përgjegjësitë e ndryshimit të raportit financiarë, e në të ardhmen i takojnë kryeshefit që do të emërohet me konkursin që është tashmë i shpallur për publikun.

Po ashtu, kërkoi të dijë se me rastin e hyrjes në funksion të procesit të koogjenerimit, pse nuk ka ndryshuar edhe çmimi për furnizim, pse nuk është ulur edhe çmimi tek konsumatorët.

**Ermal Osmani** kërkoi të dijë se a ka ndonjë plan të zgjerimit të rrjetit të Termokosit për Banesat e bardha, në lagjen "Bregu i Diellit", një lagje e vjetër e Prishtinës e cila ende nuk është kyçur në Termokos.

**Berat Lahu** tha se, sa herë që ne po debatojmë këtu për ndërmarrjet publike lokale, qëllimi ynë është tek përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, në mënyrë që edhe qytetari të ketë vullnet për të paguar, se qytetari e paguan shërbimin real e jo shërbimin e supozuar. Pra, kjo është intenca jonë për me bërë tek secila ndërmarrje publike e

Prishtinës, në mënyrë që të ketë shërbim të mirë, pastaj të vjen edhe pagesa, e cila pastaj e mundëson zhvillimin e asaj ndërmarrje. Një dukuri në këtë ndërmarrje është vërejtur ku punëtori brenda orarit të punës kryen shërbime private, i përdor asetet e ndërmarrjes për përfitim, ku bëjnë kyçe favorizuese e deri tek projektet e mëdha të cilat neglizhohen, që është dukuri tejet shqetësuese.

Ai pati një sugjerim rreth procesit të zgjedhjes së bordit, i cili tha se paraprakisht duhet të zgjidhet bordi i ri, e që me konkurs ky bord ta zgjedh drejtorin e ri, e që kjo do ta mundësonte zhvillimin e mirë të ndërmarrjes.

**Feim Osmani** kërkoi të dijë se a mund të përfundojë në këtë vit procesi për vendosjen e rrjetit të ngrohjes dhe se a e ka pasur parasysh menaxhmenti një numër të madh të banesave të cilat ju përkasin mërgatës, që edhe ata të futen në këtë proces.

**Rashit Gashi** tha se në dy seancat e mëhershme kam ngritur si shqetësim lagjen "Ramiz Sadiku", kryesisht rrugët "Johan Johan", "Jonuz Zejnullahu" dhe "Harmonia", aty ka filluar shtrirja e rrjetit por punët janë ndërprerë, andaj kërkoi të dijë se a ka ndonjë plan konkret për vazhdimin e punëve në shtrirjen e rrjetit.

**Bahri Gashi** kërkoi të dijë se si qëndron çështja e shtrirjes së rrjetit të ngrohjes në pjesët jo urbane të qytetit, a do të ketë ndonjë planifikim, e sidomos për vendbanimet e afërta siç janë Grashtica, Barileva etj.

**Sami Salihu** ngriti një shqetësim rreth punëve që Termokosi i ka bërë me rastin e ndërrimit të gypave në disa lagje të kryeqytetit, e që kompania është detyruar me i demoluar shtigjet e ecjes, të parqeve dhe një pjesë të konsiderueshme të asfalteve, po që kur e kanë përfunduar nuk e kanë rregulluar. A do të kishte mundësi që asaj kompanie t'i bëhet presion që ta kthejë gjendjen ashtu si ka qenë më herët.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

**U konstatua se u përkrah Informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Termokos" Prishtinë.**

**Pika e katërbëdhjetë  
Pyetje dhe Përgjigje**

**Bahri Gashi, për kryetarin e Komunës, nënkryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Pronës:**

- Kërkoi të dijë statusin e një parkingu të QKUK-ja, këtë pyetje e kam shtruar edhe në dy seancat e fundit.
- Z. kryetar, më keni premtuar kontratën e fushave të tenisit në Taukbaççe, te shtëpia ime, a është e gatshme dhe kur mund të pajisem me të?
- Si e keni menduar zgjatjen e orarit për stafin e Komunës dhe se a do t'iu kompensoni për orët shtesë që ata punojnë?

- Kur do të pajisemi me "bexha"- kartela të identifikimit, si dëshmi se jemi anëtarë të Kuvendit?

Lidhur me kërkesën e z. Gashi, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

**Mirsad Vitija, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Është shqetësim i qytetarëve të fshatit Barilevë, për mosfunksionimin e dritave në rrugën "Ejup Statovci", që fillon nga Besia deri në Drenoc, ka muaj që nuk funksionojnë, andaj kur do të rregullohen këto?
  - Shqetësimi i dytë është mungesa e linjave të autobusëve për në fshatin Barilevë, e që vija e fundit për në fshat është në orën 19:00, kur e dimë se deri në ora 22: 00 ka punëtorë që punojnë dhe detyrohen që për në shtëpi të kthehen me taksi ilegal.
  - Problem që vlen të veçohet për këtë lokalitet, është edhe mungesa e linjave të transportit ditëve të fundjavës, kështu që të shtunave ka vetëm dy orë, ndërsa të dielave nuk ka fare. Po ashtu, nga gjysma e muajit qershor e deri më 1 shtator, linjat e transportit janë tejet të reduktuara dhe banorëve po ju shkaktojnë shumë probleme për udhëtim të rregullt.
- Kërkoj që të gjitha këto shqetësime të qytetarëve të merren parasysh.

**Feim Osmani, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë:**

- A ka mundësi që për fshatin Trudë në planifikimin buxhetorë për vitin 2023, të parashihet zgjerimi i rrjetit të ndriçimit?
- Kërkojmë të bëhet trajtimi i varrezave, si dhe trajtimi i disa rrugicave të këtij fshati.
- Të shihet mundësia për ndërtimin e një shkolle fillore dhe të mesme të ulët, mirëpo paraprakisht duhet të bëhet zgjidhja e transportit të nxënësve.
- A ka mundësi që fshati Trudë të futet në planifikim buxhetor për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit/
- Edhe fshati Bardhosh ka disa kërkesa të cilat duan përgjigje, konkrete është vonesa e ndërtimit të rrugës kryesore të fshatit.
- Shqetësim tjetër për banorët e Bardhoshit është edhe uji që furnizohet pjesa e lartë e fshatit, sidomos për Bërniceën nga sistemi KUR "Batllava", ata po kërkojnë që të instalohet një pompë shtytëse, e cila ua mundëson furnizimin e rregullt me ujë pjesës së lartë të fshatit ku nuk mbërrin shtypja e ujit.
- A ka mundësi të rritet buxheti dhe të veprohet sikurse në rastet e mëparme që edhe Komuna të jetë pjesëmarrëse në kompensimin e asaj pjese të dëmtuar nga breshëri i fundit me mjete financiare bashkë me Ministrinë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtore.

**Endrit Zabërgja, për nënkryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Pronës:**

- Kur do të silllet Harta zonale në Kuvend?
- Kur pretendohet me u kyç në rrjetin e ngrohtores "Termokos" Lagjja e Muhaxhirëve"?
- Kur do të rregullohet ndriçimi publik?
- Kur do të bëhet ndërtimi i rrugëve, në veçanti rruga "Jashar Salihu", e cila është në gjendje tejet të mjerueshme?
- Kur do të silllet rregullorja për parqet, për Parkun e Qytetit dhe për parkun "Taukbaçë", duke e pasur parasysh që nga aty janë larguar shitësit apo të gjithë bizneset që kanë ushtruar veprimtarinë, disa janë duke punuar ilegalisht?
- A do të ketë ndonjë rregullim nën Kurriz, pasi që me rastin e reshjeve, lokalet po rrezikohen nga vërshimi i ujit?
- Në Lagjen e Spitalit, shkolla "Pavarësia" mbetet shkolla e vetme pa ndriçim, derisa rruga "Astrit Rrushi" është pa ndriçim tash e një javë, çështje e adresuar nga banorët atje. Kur do të bëhet ndriçimi i kësaj pjese të lagjes?
- Kur do ta bëjë verifikimin e pronës së Spitalit Amerikan, Komisioni për verifikimin e shfrytëzimit, verifikimin e kontratave dhe vlerësimin e tyre?

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Zabërgja, sqarime shtesë dhanë Doruntinë Maloku, drejtore dhe Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët e fshatit Prugovc kërkojnë që linjat e transportit për këtë lokalitet të jenë më të shpeshta, pasi që orari i linjave aktuale nuk i plotëson nevojat e banorëve.
- Edhe kësaj radhe përsëriti pyetjen lidhur me muret mbrojtëse në fshatin Trudë, në rrugën "Sanxhaku i Nishit" dhe në fshatin Prugovc, ku aty janë 3-4 shtëpi që vërshohen gjithë kohën në periudhën e dimrit, shkaku që janë afër lumit Llap dhe gjithë kohën ato mbeten të bllokua.
- Si do të bëhet shtrirja e rrjetit të ndriçimit të rrugëve në disa lagje të fshatit Prugovc, pasi që veç tani është zgjidhur problemi me OSHP-në.

**Berat Lahu, për nënkryetarin e Komunës:**

- Banorët e objekteve të banimit të Soliterave kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me punët rreth renovimit të pjesës së jashtme të tyre.
- Po ashtu, për të njëjtën çështje kërkesa për participim në projektin e MCC për fasadimin e objekteve është me participim, por mendoj se mundet me qenë e pamundshme për banorët në një projekt aq të madh të participojnë me 20% sepse shuma është e madhe.

**Triera Kasumi - Berisha, për kryetarin e Komunës:**

Faqe20nga24

- Kur do ta kemi Rregulloren e parqeve, dhe nëse ende nuk janë të gatshme, uroj që mos të vonohet shumë, sepse është bërë njëfarë praktike e vonesave të rregulloreve.
- Po i njëjti shqetësim është edhe për Rregulloren e NPL "Prishtina Parking", ku në mungesë të saj janë bërë shumë keqpërdorime në ndërmarrje. Keqpërdorime për të cilat nuk kemi kohë kështu t'i diskutojmë, sepse i kemi gjithë kohën nëpër medie, gjithë kohën ankesa të banorëve që nuk janë fort problematika të panjohura.
- Sa u përket shitësve ambulantë, nënkryetar gjithmonë ka shitës ambulant që funksionojnë gjithandej pa licencë dhe pa leje, por që ju kisha lutur shumë t'i aktivizoni dhe këto linjat telefonike që është e pamundur me arritur me bisedua me dikë meqë askush nuk lajmërohet.

**Besart Krasniqi, për nënkryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Meqenëse jemi në stinën e verës dhe po mbretëron vapë e madhe, nevoja për ujë të pijshëm është më e madhe, andaj duke u bazuar në atë se ka mungesë të çezmave në kryeqytet, propozoj që të bëhet ndërtimi i tyre pak më shumë në përgjithësi në qytetin e Prishtinës, sidomos në ato pjesë ku ka frekuentim të madh të qytetarëve, si p.sh. fjala nëpër sheshe, parqe ose nëpër këto pajisjet e fitnesit që janë në ambiente të hapura,
- Kam një kërkesë nga banorët që jetojnë në rrugën "Ismajl Ismajli", ish-rruga "Bledi" ata ankohen për mungesën e ndriçimit dhe kërkojnë të bëhet rregullimi i tyre, sepse as nuk janë të vendosur poçet elektrike nëpër shtylla elektrike.

*Lidhur me parashtrimin e pyetjeve nga anëtarët e kuvendit, Rashit Gashi bëri vërejtje rreth mos kthimit të përgjigjeve, i cili tha se ne vazhdimisht po kemi pyetje por përgjigje nuk po marrim, kështu që për këta muaj nuk ka ndodhur asnjë praktikë që ato pyetje që i kemi bërë, do me thënë në mënyrë verbale me marr përgjigje në mënyrë të shkruar, kështu që kjo nuk po më duket e arsyeshme..*

*Gëzim Sveçla, tha se sa i përket pyetjeve të cilat po bëhen nga anëtarët e Kuvendit, me të vërtetë është shqetësuese kjo qasje e ekzekutivit të Prishtinës dhe ajo e këshilltarëve komunalë të koalicionit qeverisës. Kjo është ajo pika e rendit të ditës ku nuk kërkohet votimi i shumicës, ku është mundësia që ne t'i paraqesim brengat tona dhe në këtë pikë nuk po marrin pjesë, që është dëshpëruese, zhgënjyese, e shpërfaq përgjegjësinë që kanë ndaj qytetit dhe ndaj qytetarëve. Unë kam një varg pyetjesh, një varg shqetësimesh të qytetarëve, por të cilat do të mbesin pa përgjigje, sepse nuk po di as kujt t'ia adresoj, personat që janë të pranishëm këtu nuk janë kompetent për pyetjet e mija.*

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Sveçla, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

**Amir Simnica, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Kërkoj që në Lagjen e Muhaxhirëve të bëhet ndriçimi i rrugëve.
- Është kërkesë e banorëve të kësaj lagjeje që të bëhet sanimi dhe ndërtimi i rrugëve, kryesisht rruga "Jashar Salihu", e cila rrugë për shkak të qarkullimit të kamionëve me pesha të rënda është shumë e dëmtuar.
- Gjithashtu është më se e nevojshme që të intervenohet edhe në rrugët "Bedri Shala" dhe "Naim Frashëri".

**Ermal Osmani, për nënkryetarin e Komunës dhe për drejtorin Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Qytetarët afër rrugës "Enver Maloku", në lagjen "Bregu i Diellit", shprehin shqetësimin e tyre lidhur me pozicionimin e auto- taksive në rrugën "Enver Maloku", te degëzimi ku fillon rruga "Armend Daci", sa për orientim pak më larg se Posta e vogël, janë të pozicionuar taksistët të cilët kanë leje për qëndrim aty, sepse qëndron edhe shenja e komunikacionit që lajmëron parkingun e rezervuar për taksitë. Sipas qytetarëve, ai vet parking i taksistëve po shkakton kolona përgjatë gjithë rrugës "Enver Maloku", sepse njëra korsi po bllokohet nga taksitë, andaj do të ishte mirë që taksistët të barten pak ma poshtë, te rruga me tri korsi, ku rrjedhimisht do të lirohet qarkullimi për vetura.

**Bahri Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës:**

- A ka mundësi të njoftohemi se kush janë anëtarët e Komisionit për verifikimin e shfrytëzimit, verifikimin e kontratave dhe vlerësimin e tyre për Spitalin Amerikan?
- A do të kishte mundësi që mos të publikohen me fotografi fytyrat e njerëzve, e që janë njerëz me halle dhe punojnë për ekzistencë, që një veprim i tillë për mua është shumë i ulët?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Gashi, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

**Violeta Salihu, për nënkryetarin e Komunës:**

- Sa i përket temës për festivalin "Sany Hill", sipas një informacioni thuhet se Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë revokimin e lejes, me qëllim që lënda të trajtohet dhe të plotësohet në bazë të Ligjit për mbrojtje e natyrës.  
A mundeni me na dhënë informata shtesë se çka është duke ndodhur?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Salihu, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

**Gëzim Mehmeti, për nënkryetarin e Komunës:**

- Sa i përket mbajtjes së festivalit "Sani Hill", kam një dilemë rreth asaj që u potencua nga parafolësja znj. Salihu, se nëse Komuna e Prishtinës ka lejuar të mbahet Sany Hill dhe në anën tjetër organi kompetent, Drejtoria e Shërbimeve Publike, e paska revokua lejen,

atëherë shihet se ka dualizëm në kuadër të ekzekutivit, dhe në momentin që drejtoria përkatëse kompetente revokon, atëherë nuk duhet të mbahet ky festival. Unë ju kisha lutur që ta bëni një zgjidhje.

## **Pika e pesëmbëdhjetë Të ndryshme**

**Gëzim Sveçla** ngriti shqetësim rreth gjendjes së krijuar kohëve të fundit në Ndërmarrjen Publike Banesore, duke thënë se është e pashpjegueshme se si ka mundësi në një kohë ku të gjitha mediet qoftë elektronike, qoftë online, i gjithë opinioni merret me këtë çështje dhe nuk kemi asnjë qëndrim zyrtar, asnjë reagim nga Komuna e Prishtinës! Duke pasur parasysh të gjitha këto ngjarje të cilat janë zhvilluar në këtë ndërmarrje, nuk kemi pasur asnjë reagim të Komunës, d.m.th. kjo qasje është shumë zhgënjyese, është dëshpëruese dhe shpërfaq një farë mungese të kompetencës të organeve komunale në raport me këtë ndërmarrje komunale, prandaj këtë e ngre si shqetësim dhe pres një reagim zyrtar nga organet komunale.

**Gëzim Mehmeti**, lidhur me disa projekte të cilat u diskutuan nga parafolësit, tha se është fakt që buxheti nuk mundë të rishikohet, mirëpo është një mundësi e cila duhet me u shfrytëzuar në kuadër të Planit të mobilitetit. Janë paraparë diku 800.000 euro, është nënshkruar kontrata në dhjetor të vitit 2021, ku nuk janë të përcaktuara rrugët, në këtë rast intervenimet, ku aty ka të bëjë edhe me shtrim asfalti, ka të bëjë me trotuaret, parqet e ndryshme. Nëse ka ndonjë kërkesë, do të ishte mirë që të merret parasysh se ka mundësi ligjore që të ndërhyhet, në këtë rast është projekti për rrugën "Bedri Shala", pastaj edhe rrugë tjera.

**Endrit Zabergja** tha se edhe pse nga Drejtoria e Inspeksionit janë liruar trotuaret para pakë kohe në lagjen "Tophane", konkretisht në rrugën "Lidhja e Prizrenit", bizneset e ndryshme kanë filluar t'i shfrytëzojnë përsëri dhe t'i uzurpojnë ato trotuare deri në pikën ku edhe i kanë rrethuar me tela të ndryshëm. Kërkesa e banoreve është që të lirohen sa më shpejt trotuaret, të vendosen korniza të cilat do të ju mundësonin në veçanti fëmijëve, të ecin lirshëm pa rreziqe. Po ashtu, të vendosen pengesa "policë të shtrirë", pasi që është një kthesë ku makinat po e rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe shpesh po shkaktohen aksidente të ndryshme.

Në lagjen "Arbëria", konkretisht për ballë "Mini Maks", është një parcelë që për shkak të humbjes së të dhënave nga lufta, rrjedhimisht mbi 70 persona janë në bashkëpronësi dhe ata nuk janë duke pasur mundësi që pronat e tyre me i përkthyer në emrin e vetë, me aplikuar për leje ndërtimi apo edhe për shitblerjen. Do të ishte më se e domosdoshme që ekzekutivi ta kenë parasysh këtë problem dhe të bënë një zgjidhje.

**Milazim Vitija** kërkoi nga të gjithë të pranishmit që ta respektojnë Rregulloren e Kuvendit, kryesisht rreth diskutimit për pikat e rendit të ditës.

Sa u përket ndërmarrjeve publike, ne mundemi me dhënë vetëm një informatë, prandaj kisha bërë lutje që të zbatohet rregullorja, ku çdo njeri ta ketë parasysh se çka duhet me diskutuar e çka duhet mos me diskutuar.

**Triera Kasumi-Berisha** ngriti shqetësim, duke thënë se në rrethinën e kryeqytetit kemi më shumë mbeturina, të cilat nuk janë as të klasifikuara, dhe ka gjithfarë mbetje. Krahas kësaj kemi parë disa raste ku ka pasur ndezje të vogla të zjarreve, të cilat mundën me qenë kërcënim edhe për biodiversitetin, natyrën në përgjithësi dhe jetën e njerëzve.

Një kërkesë tjetër do të ishte edhe printimi i disa materialeve të mbledhjeve, që është dashtë bile disa prej materialeve me i pasur të printuara.

Sa i përket injorancës tonë, siç po quhet kështu, për daljen nga seanca, është shumë e pakapshme me tingëlluar si të tillë, sepse ne jemi bashkëpunues, kemi qenë prej fillimit dhe jemi shumë racional e konstruktiv.

Por, përderisa nuk merren parasysh edhe kërkesat tona për një ndërmarrje, siç është "Ndërmarrja Publike Banesore", e cila është në një kaos po aq të thellë sa ndërmarrja "Pastrimi", besoj që kemi arsye të plotë për veprimin që e kemi bërë si grup.

*Mbledhja përfundoi në orën 18:45.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi



Faqe24nga24